RREGULLORE

MBI
STANDARDET TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE PËR SIGURINË DHE INTEGRITETIN E RRJETAVE DHE/OSE SHERBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të;

- Parimeve themelore dhe obligimeve që dalin nga përcaktimet e Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike *(tutje; Ligji ose LKE)*, respektivisht nenet; neni 10 paragrafët; 4), 7) dhe 21); neni 85 paragrafët; 1) dhe 4) dhe përcaktimet e aplikueshme nga Kreu XVII i Ligjit;

- Parimeve themelore dhe obligimeve që dalin nga përcaktimet e Ligjit Nr. 05/L-030 për Përgjimet e Komunikimeve Elektronike *(tutje; LPKE)*, respektivisht nenet; neni 4, neni 17 paragrafi 4) dhe neni 21 paragrafi 21;

- Dokumentit të Politikave të Sektorit të Komunikimeve Elektronike *'Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020'* dhe Planit Afatmesëm 2015 – 2017 për Adresimin e Objektivave Rregullatore të parapara me Kornizën Rregullatore (*Legjislacioni Primar dhe Sekondar*) përfshi dokumentin e Planit të Veprimit për Adresimin e Objektivave për Themelimin dhe Funksionalizimin e KOS-CERT.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Neni 1
Fushëveprimi dhe Qëllimi i Rregullores

1.1. Përmes kësaj rregulloreje definohen të drejtat dhe detyrimet e operatorëve që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe definon standardet teknike të nevojshme për marrjen e masave në parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve për të garantuar sigurinë, integritetin dhe funksionimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;

1.2. Obligohen operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të krijojnë/përmirësojnë me tutje mekanizmat e duhur për detektimin, parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike dhe të paraqesin pranë ARKEP, sipas Shtojcës nr. 1) dhe Shtojcës nr. 2) të kësaj rregulloreje, çdo ndërhyrje, cenim ose incident që ka një impakt të konsiderueshëm në funksionimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të tyre.

Neni 2
Përkufizimet

Për qellim të kësaj rregulloreje;

2.1. Kuptimi dhe definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje në bazë të legjislacionit të aplikueshëm[1], do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në ketë rregullore.

2.2. Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë ketë kuptim;

2.2.1. ***'Të dhënat elektronike'*** nënkuptojnë të dhënat e procesuara me anë të pajisjeve të teknologjisë informative që kanë funksione për procesimin e të dhënave;

2.2.2. ***'Ndërprerja e Shërbimeve (DoS)'*** nënkupton aksionin, i cili interferon *(ndërhynë)* në punën dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve dhe/ose sistemin e informacionit, ose sigurimin e shërbimeve të ofruara përmes rrjetës së komunikimeve elektronike;

[1] Referuar ligjeve të listuara në nenin 1 të kësaj Rregulloreje

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

2.2.3. ***'Koprimimi i Sistemit'*** nënkupton qasjen dhe përdorimin në mënyrë të paligjshme të resurseve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;

2.2.4. ***'Softuer i Dëmshëm (Malicious Sofware)'*** nënkupton një softuer ose një pjesë e tij i dizajnuar që në mënyrë të paligjshme të lidhet *(qaset)* apo të mundësoj qasje të paautorizuar në një sistem të informacionit ose në një rrjetë publike të komunikimit, ndërprerje ose ndryshim, gjithashtu marrje nën kontroll të menaxhimit të funksionimit të sistemit të informacionit ose rrjetës publike të komunikimit, shkatërrim, dëmtim, fshirje ose ndryshim te të dhënave elektronike, eliminim ose kufizim të mundësisë për të përdorur të dhënat elektronike, lejimin e shpërdorimit ose tjetër përdorim te të dhënave elektronike jo publike për njerëzit, të cilët nuk kanë të drejt të bëjnë këtë;

2.2.5. ***'Veprim me qëllim të keq'*** nënkupton një veprim, lëshim ose kërcënim në sigurinë dhe integrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike;

2.2.6. ***'Përdorim i jashtëligjshëm i të dhënave elektronike'*** nënkupton përvetësimin, shpërndarjen, dhe publikimin e të dhënave elektronike, zëvendësimin e tyre me të dhëna tjera elektronike, shtrembërimin e të dhënave elektronike ose ndonjë përdorim tjetër të jashtë ligjshëm të tyre;

2.2.7. ***'Cenimi i Integritetit'*** nënkupton keq funksionimin e rrjetës dhe/ose shërbimit ose një pjese të saj duke pamundësuar ofrimin e shërbimeve elektronike publike ose shërbimet elektronike të informacionit të ofruara nëpërmjet kësaj rrjete, si dhe/ose dëmtimi i pajisjeve të përdorura nga shfrytëzuesit;

2.2.8. ***'Rregullat mbi menaxhimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike'*** nënkuptohet komplet dokumentacioni i aprovuar nga rrjetet e komunikimeve publike dhe/ose ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në vendosjen e masave teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë dhe integritetit të operatoreve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike;

2.3. Termet tjera të përdorura në rregullore janë të definuar në Ligjin për Komunikime Elektronike, Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Neni 3
Parimet e përgjithshme

3.1. Kjo Rregullore synon;

a) Të përcaktojë objektivat dhe standardet teknike të nevojshme për garantimin e funksionimit të mirëfilltë të infrastrukturës së rrjetit dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik nga operatoret që ofrojnë qasje në rrjetet e komunikimit publik dhe/ose në shërbimet e komunikimit publik, në respekt të konfidencialitetit, integritetit dhe ofrimit të pandërprerë të shërbimeve,

b) Të përcaktojë të drejtat edhe obligimet e operatoreve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në garantimin e sigurisë dhe integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të ofruara nga ta,

c) Të përcaktojë masat bazë të aplikuara në menaxhimin e incidenteve dhe informacionet teknike në vendosjen e kushteve të sigurisë kibernetike të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

d) Të përcaktojë procedurat për hetimin e incidenteve dhe shkeljes së integritetit.

e) Të përcaktoje detyrimin e operatoreve për të informuar ARKEP në lidhje me incidentet apo cenimet e sigurisë bazuar në ndikimin e incidentit në funksionimin normal të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të ofruara.

f) Standardizimi në vlerësimin dhe raportimin e masave të sigurisë të ndërmarra nga operatoret me qëllim të parandalimit dhe detektimit të incidenteve kibernetike ose cenimit të integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

g) Mënyrën dhe përmbajtjen e raportimit te masave të sigurisë dhe incidenteve te sigurisë qe duhet dorëzuar ne ARKEP.

h) Të përcaktoje sanksionet, masat administrative në rast se operatoret dështojnë në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Neni 4
Fusha e zbatimit të Rregullores

4.1. Përcaktimet e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë operatorët e autorizuar nga ARKEP të cilët ofrojnë qasje në rrjetet dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU I

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E OPERATORËVE PËR MBROJTJEN E SIGURISË DHE INTEGRITETIT TË RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve

Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të;

5.1. Implementojnë masat adekuate teknike dhe organizative që garantojnë siguri të rrjeteve publike të komunikimit dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike të ofruara nga ta. Këto masa duhet të garantojnë nivel të sigurisë në përputhje me kërcënimet e paraqitura, dhe parandalojnë incidentet e sigurisë, ose zvogëlojnë ndikimin e tyre në rrjetet publike të komunikimit dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike.

5.2. Implementojnë masat adekuate teknike dhe organizative që garantojnë bllokimin e trafikut ose IP adresave false në rrjetet publike të komunikimeve elektronike të ofruara nga ta.

5.3. Implemetojnë masat adekuate teknike dhe organizative që garantojnë bllokimin e trafikut që ka shkaktuar ndërprerjen e shërbimit (DoS) në rrjetet dhe/ose shërbimet publike të komunikimeve elektronike të ofruara nga ta.

5.4. Implementojnë masat adekuate teknike dhe organizative që garantojnë integritetin e rrjeteve të tyre publike për sigurimin e pandërprerë të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpër këto rrjeta.

5.5. Implementojne masat adekuate teknike dhe organizative që garantojnë sigurinë e pajisjeve të përdorura për mbrojtjen e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të ofruara nga to.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

5.6. Aprovojnë dhe rregullisht i përditësojnë rregullat e menaxhimit të sigurisë së rrjeteve publike të komunikimeve dhe shërbimeve të ofruara.

5.7. Përshkruajnë dhe aplikojnë masat e nevojshme për parandalimin, detektimin dhe menaxhimin e incidenteve dhe cenimit të integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

5.8. Përpilojnë planin për garantimin e vazhdueshëm të sigurisë së rrjeteve publike të komunikimeve dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik publik dhe kushtet e aplikimit te tyre.

5.9. Përcaktojnë qartë funksionin dhe përgjegjësinë e punonjësve të ngarkuar me parandalimin, detektimin dhe menaxhimin e incidenteve dhe shkeljes së integritetit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve që i ofrojnë.

5.10. Përpilojnë procedurat dhe kushtet për inspektim dhe testim në aspektin e sigurisë të pajisjeve të përdorura për ofrimin e rrjeteve publike për komunikime elektronike dhe/ose shërbimet e komunikimeve elektronike publike.

5.11. Të informojnë menjëherë dhe pa pagesë përdoruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike rreth mos funksionimit të rrjetës dhe/ose shërbimit publik të komunikimit gjatë ndonjë incidenti dhe/ose shkelje te integritetit e klasifikuar si me ndikim të mesëm ose të lartë.

5.12. Të informojnë pa pagesë përdoruesit e shërbimeve të rrjeteve publike te komunikimeve elektronike rreth masave që përdoruesit e këtyre shërbimeve mund të marrin në eliminimin e rrezikut të incidenteve dhe/ose shkeljes së integritetit të ndërlidhur me pajisjen e terminalit të përdoruesve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe të tregojnë implikimet e kostos së marrjes së këtyre masave.

5.13. Jo më vonë se para 5 ditëve të punës duhet të informojnë përdoruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike rreth planifikimit të punëve që mund të ndikojë në cenimin e sigurisë dhe/ose integritetit të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të ofruara.

5.14. Shpall publikisht rekomandimet për përdoruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike rreth masave që duhet të ndërmarrin për garantimin e sigurisë kibernetike gjatë përdorimit të shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

5.15. Ofruesit e shërbimeve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike kanë të drejtë të marrin masa urgjente, duke përfshirë kufizime të përkohshme në ofrimin e shërbimeve për përdoruesit e këtyre shërbimeve, kur incidenti dhe/ose shkelja e integritetit ka ndodhur ose kërcënimi i incidentit dhe/ose shkelja e integritetit është e pranishme.

KREU II
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit

6.1. Garanton ruajtjen e integritetit te të dhënave të operatoreve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nga modifikimet e tyre pa autorizim ose jo të kërkuara nga operatori përkatës.

6.2. Garanton ruajtjen e konfidencialitetit te të dhënave të operatoreve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike prej personave jo te autorizuar me përjashtim të kërkesave që vijnë nga organet dhe institucionet sipas legjislacionit në fuqi.

6.3. Ushtron kompetencat në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

6.4. Kryen hulumtime nëse e shikon të nevojshme, mbi incidentet e sigurisë të raportuara nga operatoret duke ruajtur gjithmonë sekretin dhe anonimitetin e hetimit.

6.5. Njofton përdoruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve rreth incidentit të sigurisë, në rast se e konsideron si të lartë impaktin e incidentit të sigurisë,

6.6. Kryen kontrolle në mënyre periodike në bashkëpunim me njësinë KOS-CERT, për të verifikuar implementimin e kësaj rregulloreje.

6.7. Ndërmerr masa sipas legjislacionit në fuqi nëse operatoret nuk plotësojnë kërkesat dhe kushtet e kësaj rregulloreje.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

KREU III
PROCEDURAT DHE KUSHTET E DHËNIES SË INFORMACIONIT NË LIDHJE ME INCIDENTET DHE/OSE CENIMIN E INTEGRITETIT DHE MASAT QË DUHET TË MERREN PËR MENAXHIM

Neni 7
Procedurat, kushtet dhe menaxhimi i informacionit

7.1. Ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të informojnë Autoritetin në lidhje me incidentet e mëposhtme:

i. Ndërprerjen e shërbimit;

ii. Koprimimin e sistemit të informacionit;

iii. Shfrytëzimin e paautorizuar te të dhënave elektronike;

iv. Veprimet që ndërlidhen me softuerët e dëmshëm;

v. Cenimet e integritetit;

7.2. Ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet informojnë menjëherë Autoritetin pasi që të kenë konstatuar incidentet dhe/ose cenimin e integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve në lidhje me:

7.2.1. Incidentet dhe/ose cenimet e integritetit që kanë ose kanë pas ndikim të lartë *(sipas Shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje)* në shfrytëzuesit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofrohen nga ta.

7.2.2. Incidentet dhe/ose cenimet e integritetit qe kane ose kanë pas ndikim te lartë *(sipas Shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje)* në sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, po ashtu edhe në sistemet e informacionit që ofrohen nga operatoret e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës.

7.3. Ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet informojnë menjëherë Autoritetin jo më vonë se 1 ditë pune pas konstatimit të ndodhjes së incidentit dhe/ose cenimit të integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve në lidhje me;

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

7.3.1. Incidentin dhe/ose cenimin e integritetit, që ka pas më herët ose do të ketë ndikim mesatar *(sipas Shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje)* në shfrytëzuesit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofrohen nga ta.

7.3.2. Incidentet dhe/ose cenimet e integritetit që kanë ose kanë pas ndikim mesatar *(sipas Shtojcës nr. 1 të kësaj rregulloreje)* në sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, po ashtu edhe në sistemet e informacionit që ofrohen nga operatoret e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës.

7.4. Operatoret e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të informojnë Autoritetin në lidhje me ngjarjet e specifikuara në Pikën 7.2 dhe 7.3 të rregullave dhe procedurave që duhet të ndiqen dhe janë të përshkruara në ueb faqen www.kos-cert.org/raportet ; në mungese të kësaj mundësie duhet të postojnë njoftimin ne email: reports@kos-cert.org sipas formës të përcaktuar në Shtojcën nr. 2), duke enkriptuar përmbajtjen e njoftimit përmes çelësit publik 0xYYYYYY, dhe në pamundësi të këtyre dy opsioneve të mësipërme të informojnë Autoritetin përmes telefonit xxxxxx ose fax; xxxxxxxxx

7.5. Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike duhet të komunikojnë te Autoriteti informatat e kontaktit të personit përgjegjës i cili do të kontaktohet në rastin e ndonjë incidenti dhe/ose cenimi të integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe emailin elektronik përkatës për shkëmbim të menjëhershëm të informacionit të enkriptuar; nëse personi përgjegjës do të ndryshojë informatat e kontaktit, informacionet e reja të kontaktit duhet të komunikohen menjëherë te Autoriteti më së largu një dite pune.

7.6. Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë të drejtë të informojnë Autoritetin sipas dëshirës së vet në lidhje me ngjarjet tjera të rëndësishme në lidhje me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

KREU IV
KONFIDENCIALITETI DHE VLERËSIMI I IMPAKTIT TË INCIDENTEVE

Neni 8
Konfidencialiteti i Komunikimeve

8.1. Konfidencialiteti i komunikimeve dhe i trafikut të të dhënave në rrjetet e komunikimeve elektronike publike dhe/ose në shërbimet e tyre duhet të garantohet nga ofruesit e tyre. Operatoret në mënyrë specifike duhet të parandalojnë përgjimin ose interceptimin e thirrjeve telefonike ose format e tjera të përgjimit të komunikimeve dhe trafikut të të dhënave nga persona përtej atyre të përfshirë direkt në komunikim, me përjashtim të rastit kur diçka e tillë është ligjërisht e autorizuar.

8.2. Përjashtohen nga detyrimi i përcaktuar në Pikën 8.1 regjistrimet e autorizuara ligjërisht të komunikimeve kur ndërmerren në kuadrin e praktikave të ligjshme të biznesit për qëllimin e ofrimit të evidencës të një transaksioni komercial ose të ndonjë komunikimi tjetër biznesi.

8.3. Operatorët duhet të garantojnë përdorimin e mjeteve të duhura në sistemet e komunikimeve elektronike dhe në sistemet e procesimit të të dhënave për të mbajtur sekret komunikimet elektronike dhe të dhënat personale të përdoruesve, po ashtu për të ndaluar qasjen e pa-autorizuar në këto sisteme.

8.4. Operatorët, personat e autorizuar, punonjësit dhe çdo individ i përfshirë në sistemet e komunikimeve elektronike, pjesë e strukturave të operatorit-eve janë përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe komunikimeve.

8.5. Operatorët duhet të mbledhin të dhëna në lidhje me përdoruesit e tyre vetëm për qëllim dhe deri në shkallën e nevojshme për të kryer detyrën e tyre të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve publike.

8.6. Operatorët duhet të informohen në lidhje me mesazhet ose të dhënat e transmetuara përmes rrjetit të tyre vetëm deri në shkallen e nevojshme për të kryer detyrën e tyre të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve publike.

8.7. Marrja, regjistrimi, publikimi dhe përdorimi i të dhënave dhe mesazheve të transmetuar nga rrjetet e komunikimit publik dhe që nuk janë të destinuara për publikun, po kështu dhe shpërndarja e tyre te njerëz/persona të pa-autorizuar janë të ndaluara nëse nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Neni 9
Vlerësimi i impaktit të incidenteve të sigurisë

9.1. Operatorët duhet të kryejnë vlerësimin e impaktit të incidenteve të sigurisë sipas tabelës së paraqitur në Shtojcën nr. 1).

9.2. Incidentet e sigurisë që kanë pasur kohëzgjatje më pak se një (1) orë, në mënyrë automatike konsiderohen si të një impakti të ulët dhe nuk është i nevojshëm plotësimi i tabelës.

9.3. Incidentet e sigurisë konsiderohen si incidente me impakt të lartë nëse numri i përdoruesve të ndikuar nga incidenti ose përqindja e tyre (%) ndaj përdoruesve total është minimalisht 1000 ose 5%.

9.4. Në çdo rast tjetër, incidentet e sigurisë konsiderohen si incidente me impakt mesatar.

9.5. Në vlerësimin përfundimtar të impaktit, duhet patur parasysh se nëse incidenti i sigurisë është konsideruar i lartë nga minimalisht një (1) parametër *(mesatar nga parametri tjetër)*, atëherë ai konsiderohet një incident me impakt të lartë dhe në vlerësimin përfundimtar.

9.6. Tabela për vlerësimin e impaktit te incidentit te sigurisë mund te ri-plotësohet sa here qe kemi një ndryshim te parametrave ne lidhje me kohëzgjatjen e incidentit te sigurisë, numrin e përdoruesve te prekur dhe zonën gjeografike te shtrirjes se incidentit te sigurisë.

9.7. Brenda 15 ditëve pune pas përfundimit te incidentit te sigurisë, operatoret duhet te kryejnë vlerësimin përfundimtar te impaktit te incidentit te sigurisë dhe te paraqes pran Autoritetit një raport të përmbledhur në lidhje me rastin.

KREU IV
RAPORTIMI DHE INVESTIGIMI I INCIDENTEVE

Neni 10
Raportimi i masave të sigurisë dhe auditimi

10.1. Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike që rezultojnë sipas raportimeve të kryera ne ARKEP me të ardhura vjetore te vitit paraardhës nga komunikimet elektronike nën vlerën prej; 500 000 euro duhet të raportojnë pranë ARKEP në formën e një vet deklarimi periodikisht një herë në vit brenda muajit Janar

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

për vitin paraardhës sipas procedurave të raportimit të adoptuara nga ENISA që do të përditësohen kohe pas kohe dhe do te bëhen publike për çdo vit nga ana e Autoritetit.

10.2. Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike qe rezultojnë sipas raportimeve te kryera ne ARKEP me të ardhura vjetore te vitit paraardhës nga komunikimet elektronike mbi vlerën 500 000 euro, duhet qe të dorëzojnë pranë ARKEP raportin me rezultatet e auditit të sigurisë, të kryer nga një organ i certifikuar dhe i pavarur ose nga autoriteti kompetent. Raporti duhet te dorëzohet periodikisht për një periudhe jo me shume se dy vjeçare. Kostoja e auditimit duhet të paguhet nga ana e operatorit.

Neni 11
Raportimi i incidenteve të sigurisë

11.1. ARKEP kërkon që ndërmarrësi i autorizuar të ofroj informacionet e nevojshme për të vlerësuar sigurinë dhe/ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve, duke përfshirë politikat e dokumentuara të sigurisë.

11.2. Operatorët duhet të njoftojnë dhe të dërgojnë Formularin e Shtojcës nr. 2) pranë Autoritetit jo më vonë se brenda tre (3) ditëve nga momenti i zbulimit të incidentit të sigurisë. Kjo duhet bërë vetëm pas vlerësimit të impaktit të sigurisë dhe vetëm nëse ai rezulton mesatar ose i lartë.

11.3. Ky njoftim i parë duhet të përmbaj të paktën informacionet e mëposhtme;

a) vlerësimin se cilat rrjete ose shërbime te komunikimit publik janë ndikuar ose do te ndikohen nga incidenti i sigurisë;

b) vlerësimin e zonës gjeografike qe është dhe/ose do te ndikohet nga incidenti i sigurisë;

c) vlerësimin e segmentit te përdoruesve qe janë ndikuar ose do te ndikohen nga incidenti i sigurisë;

d) vlerësimin e planit te rimëkëmbjes;

e) vlerësimin paraprak te shkakut ose shkaqeve, qe operatori mendon se kane shkaktuar incidentin e sigurisë.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

11.4. Njoftimi fillestar dërgohet te ARKEP përmes e-mailit reports@kos-cert.org dhe/ose përmes instrumenteve të tjerë të vendosur në dispozicion për këtë qellim nga ARKEP.

11.5. Në rastin ku kemi një ndryshim të rëndësishëm të të dhënave të përcaktuara në pikën 11.3), operatori paraqet shpejt pranë ARKEP një njoftim të ri.

11.6. Brenda 15 ditëve nga ndodhja e incidentit te sigurisë, operatoret duhet te paraqesin njoftimin përfundimtar ne lidhje me incidentin e sigurisë. Njoftimi përfundimtar dërgohet në ARKEP sipas përcaktimeve të pikës 11.3).

11.7. ARKEP mund të kërkoj të dhëna të tjera shtesë, përveç atyre në formularin përfundimtar në lidhje me incidentin e sigurisë. Për këtë arsye, operatorët janë të detyruar të ruajnë të gjitha të dhënat në lidhje me incidentet e sigurisë së raportuar për një periudhe kohore prej 18 muaj që nga koha e dorëzimit të njoftimit përfundimtar rreth incidentit të sigurisë.

Neni 12
Investigimi i incidenteve të sigurisë dhe cenimit të integritetit

12.1. Duke vlerësuar nivelin e rrezikut të incidentit të raportuar, KOS-CERT ndërmerr hapa të nevojshëm në hulumtimin e incidentit dhe rrethanave specifike bazuar në procedurat e brendshme për koordinim të incidenteve.

12.2. Për incidentet të cilat vlerësohen me ndikim të lartë *(bazuar në Shtojcën nr. 1 të rregullores)* duhet të fillohet të merren masa te menjëhershme reaguese për koordimin e incedenteve me organet tjera relevante posa te jete pranuar njoftimi nga operatoret e rrjeteve dhe/ose shërbimeve te komunikimeve elektronike.

12.3. Për incidentet të cilat vlerësohen me ndikim mesatar *(bazuar ne Shtojcën 1 të rregullores)* duhet të merren masa reaguese vetëm pas kompletimit të hulumtimit ose jo më vonë se tri (3) ditë pune pas pranimit të njoftimit nga operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

12.4. Nëse gjate vlerësimit te incidentit te pranuar operatoret e rrjeteve dhe shërbimeve te komunikimeve elektronike është konstatuar se raporti (*bazuar ne Shtojcën 1 të rregullores)* nuk është i kompletuar, Autoriteti (njësia KOS-CERT) duhet te njoftoj operatorin përkatës qe me se paku brenda një dite te dorëzoj raportin e kompletuar me te dhëna korrekte.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

12.5. Shkëmbimi i informacioneve me palët mund të përfshijë komunikimin e informatave mes palëve kompetente si;

12.5.1. Agjensioni shtetëror për mbrojtjen e të dhënave personale për informatat që kanë të bëjnë me të dhënat personale;

12.5.2. Policinë nëse ka shenja të aktivitetit kriminal;

12.5.3. Ministrinë e Punëve të Brendshme në lidhje me incidentet që mund të afektojnë burimet shtetërore të informacionit dhe aktivitetet e dëmshme që ndërlidhen me infrastrukturën kritike të informacionit.

12.6. Autoriteti duhet të kujdeset që të sigurojë konfindicialitetin e informacioneve të shkëmbyera nga qasja, kopjimi, manipulimi dhe përdorimi i paautorizuar.

12.7. Autoriteti në mënyrë të rregullt mbledh informacione nga raportet në lidhje me incidenteve dhe masave të ndërmarra të plotësuara nga operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe në baza vjetore kontribuon në plotësimin e raportit vjetor të përmbledhur shtetëror që i dërgohet ENISA.

Neni 13
Zbatimi i rregullores

13.1. Të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike publike janë të detyruar të zbatojnë këtë rregullore. Ndërmarrjet e autorizuara do të jenë subjekt i masave administrative nëse konstatohet se kanë vepruar në kundërshtim me këtë rregullore;

- nuk kanë përmbushur një ose disa nga detyrimet e nenit 3;
- nuk kanë raportuar pranë ARKEP incidentet e sigurisë të një impakti mesatar dhe/ose të lartë;
- nuk kanë respektuar afatet e njoftimit dhe raportimit pranë ARKEP të incidenteve të sigurisë;
- kanë bërë një vlerësim jo të saktë dhe të vërtetë të impaktit të incidentit të sigurisë duke mënjanuar në këtë mënyrë detyrimin e raportimit;
- kanë plotësuar formularin në Shtojcën nr. 1) me të dhëna të rreme ose nuk e kanë plotësuar atë në mënyrë të plotë;
- nuk kanë ruajtur të dhënat ne lidhje me incidentet e sigurisë së raportuar për një periudhe kohore prej 18 muaj që nga koha e dorëzimit të njoftimit përfundimtar rreth incidentit të sigurisë.

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

13.2. Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore paraqet dhe përbën kundërvajtje administrative dhe në këto raste Autoriteti do i zbatoj masat proporcionale si të parapara me Kreun e XVI të LKE-së.

Neni 14
Dispozitat Përfundimtare

14.1. Në rast të ndonjë kontesti eventual në mes të operatorëve të komunikimeve elektronike, sektorit publiko-privat, shfrytëzuesve të shërbimeve dhe rrjeteve në aspektin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve, ata kanë të drejtë që të paraqesin ankesë pranë ARKEP. Ankesa do të shqyrtohet konform dispozitave të LKE-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo legjislacionit sekondar rregullator të miratuar dhe publikuar nga Autoriteti.

14.2. Ky akt do të jetë subjekt i çfarëdo apelimi nga palët e pakënaqura përmes procedurave administrative gjyqësore, konform procedurave dhe ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 15
Hyrja në fuqi

15.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e saj të miratimit nga Bordi Drejtues i Autoritetit dhe mbetet në fuqi derisa nuk adoptohet rregullore tjetër.

Prishtinë, xx/ 12/ 2015

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Shtojca 1- VLERËSIMI I IMPAKTIT TË INCIDENTIT TË SIGURISË

TABELA PER VLERESIMIN E IMPAKTIT TE INCIDENTIT TE SIGURISE

Kohëzgjatja e incidentit të Sigurisë (ndërprerjes së shërbimit, interceptimit të komunikimeve, softëuare të dëmshëm, vjedhja, modifikimi i te dhënave)	*Më tepër se 1 orë, por më pak se 2 orë*	*Më tepër se 2 orë*
Numri i përdoruesve të prekur nga incidenti ose % e tyre ndaj numrit total të përdoruesve të ofruesit		
>1000 ose >5%	*Mesatar*	*I Lartë*
Në rast të një numri të panjohur të përdoruesve të prekur nga incidenti i sigurisë, zona gjeografike e shtrirjes së incidentit të sigurisë		
>10 km²	*Mesatar*	*I Lartë*
Vlerësimi Përfundimtar i Impaktit: **Mesatar** **I Lartë**		

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Shtojca 2- FORMULARI MBI RAPORTIMIN E INCIDENTEVE KOMPJUTERIKE

1. Informacionet Kontaktuese

Emri	
Mbiemri	
Email	
Telefoni	
Fax	
Organizata / Kompania	
Adresa e Organizatës / Kompanisë	
Sektori	☐ Shtetëror ☐ Privat ☐ Publiko-Privat

2. Informacionet mbi Paisjen (HOST)

Emri i Kompjuterit	
Specifikimi Harduerik i Kompjuterit	
Verzioni i sistemit Operativ	
Lokacioni i Paisjes ne rrjetë (ISP)	

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

IP Adresa e Paisjes (Hostit)	
Kategorizimi i Paisjes (Hostit) te perfshire ne incident ☐ Viktimë ☐ Sulmues	

3. Informacionet rreth Incidentit

Data dhe koha e zbulimit të Incidentit				Ora
	Dita	Muaji	Viti	
Përshkrimi i Incidentit	☐ Kod Qëllim keq (virus , work ose Trojan horse) ☐ Qasje e Pa autorizuar (Intrusion / Hack) ☐ Shkëputje e Shërbimit (Denail of Service) ☐ Sulm Vizual i Ueb Faqes (Website Defacement) ☐ Keq përdorim I Sistemit (përdorim irrelevant nga punetori) ☐ Kërcënim apo Ngacmim (Threat / Harassment) ☐ Tjeter (Specifiko më Poshtë) :			

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

Mënyra e identifikimit të Incidentit	☐ Sistemi IDS ☐ Analiza e Log Fajllit ☐ Dyshimet e Administratorit të sistemit ☐ Ankesa nga përdoruesit ☐ Njoftimi nga pala e tretë ☐ Tjetër (specifiko): ……..
Detajet dhe veprimet e ndërmarra ndaj Incidentit	
Ndikimi (Impakti) i Incidentit	☐ Humbja / Rrezikimi i Sistemit të të Dhënave ☐ Jo Produktivitet (Downtime) ☐ Dëmtim të Sistemeve ☐ Ndikimi në sistemet e organizatave tjera ☐ Dëmtim në integritetin dhe dërgimin e materialeve kritike, shërbimeve ose informatave. ☐ Humbje Financiare

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

LLoji / Funksioni i sistemit të ndikuar	☐ Application Server ☐ Database Server ☐ Desktop (End User) ☐ Domain Controller ☐ Domain Name Server ☐ File Server ☐ Firewall ☐ Laptop ☐ Mail Server ☐ Proxy Server ☐ Router ☐ Switch ☐ Server ☐ Time Server ☐ Web Server ☐ Tjeter (specifiko) ……

Sistemi Operativ i sistemit te ndikuar nga Incidenti

☐ Apple Mac OS X	☐ Mandrake Linux	☐ Windows 9x/Me
☐ Apple Mac OS 9.1 or earlier	☐ Red Hat Linux	☐ Windows NT 3.x/4.0
☐ CISCO IOS	☐ Slackware Linux	☐ Windows 2000 Professional
☐ FreeBSD	☐ Sun Solaris(End User)	☐ Windows 2000 Server (Any)
☐ NetBSD	☐ SuSE Linux	☐ Windows XP
☐ OpenBSD	☐ Novell	☐ Windows 2003 Server
☐ IBM AIX	☐ SCO Unix	☐ Pa Njohur
☐ Fedora Linux	☐ SGI Irix	☐ Tjeter *(Specifiko):* ……

Lloji i Log-ut te mbajtur	☐ System Logs ☐ Security Logs ☐ Access Logs

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org

4. Ndihma e kërkuar nga KOS-CERT

Asistenca nga KOS-CERT	☐ Koordinimi ☐ Ofrimi I konsultave rreth incidenteve ☐ Kategorizimi I Incidenteve
Rëndësia e ndikimit të Incidentit	☐ Kritike ☐ E Rëndësishme ☐ Shumë e Rëndesishme ☐ Jo e Rëndësishme
Backup Sistemi	☐ PO ☐ JO

Nënshkrimi: Data: ……..	**Vula e Organizatës / Kompanisë**

/ Kjo formë përdoret vetëm për raportimin e incidenteve të sigurisë kibernetike. Kompletimi i kësaj forme duhet të bëhet brenda 24 orëve të shfaqjes së incidentit të sigurisë kompjuterike.*/*

Adresa; Qyteza Pejton, rr. 'Mujo Ulqinaku' nr. 7, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: + 381 38 212-345; Fax: + 381 38 212 399;
E-mail; info@arkep-rks.org; ueb-faqe; www.arkep-rks.org